



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion

Mbledhja nr. 51

Prishtinë, më 11 qershor 2012, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N - 225

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion

Në mbledhje morën pjesë: Arben Gashi- kryetar i Komisionit, Mufera Şinik, Behar Selimi, Halit Krasniqi, Ardian Gjini, Amir Ahmeti, Albulena Haxhiu, Armend Zemaj dhe Haki Demolli.

Munguan: Arsim Bajrami dhe Jasmina Zhivković.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Syzan Bytyqi Jgxiu – Zyra e BE-së, Lumnije Murati – ZPRK, Agron Vrenezi – OHCHR, Sylë Ahmeti – Kosova Sot, Rianna Martineze – KDI, Guillermo Gomez – KDI, Florije Mehmeti – KDI, Vlora Marmullakaj – EULEX, Jeton Bytyqi – OSBE, Ralph Bunche – OSBE, Lizabeta Paloka – OSBE, Lejla Selimi-OSBE, Shpëtim Peci dhe Halil Kurumeli – NDI, Bajram Gecaj, Alex Tractnsen dhe Jon Smibert – US Embassy.

Nga Stafi i Komisionit për Legjislacion: Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni dhe Visar Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Arben Gashi, kryetar i Komisionit.

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 07 dhe 14.05.2012;
3. Shqyrtimi në parim i Projekt- kodit të procedurës penale;
4. Shqyrtimi i kërkesës së Këshillit Gjyqësor të Kosovës lidhur me aktivitetet e tij;
5. Shqyrtimi i propozimeve për anëtarë të Këshillit në Komisionin për Ndihmë juridike falas;
6. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Kryetari propozoi që si pika të rendit të ditës të përfshihen:

- Shqyrtimi i kërkesës së Presidentes drejtuar kryetarit të Komisionit, si anëtar në Këshillin kombëtar kundër korrupsionit;
- Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funkcional në Projektligjin Nr. 04/L-116 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L- 04 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë;
- Shqyrtimi i kërkesës së Gjykatës Kushtetuese lidhur me ligjin për pensionet e pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës;
- Shqyrtimi i amendamentit në Projekt-kodin penal të Kosovës.

Rendi ditës u miratua me ndryshimet e propozuara.

2. Shqyrtimi në parim i Projekt- kodit të procedurës penale

Armend Zemaj – E përkrahu që Projekt-kodi i procedurës të shkojë për lexim të parë dhe propozoi të formohet një grup punues i cili i cakton edhe ekspertët dhe formën e punës të cilën do ta zhvillojë.

Kryetari propozoi që ekspertët të caktohen në këtë mbledhje deri sa Projekt-kodi i procedurës mund të procedohet për leximin e parë.

Haki Demolli- Propozoi që nga Fakulteti Juridik të jenë ekspertë Ejup Sahiti dhe Rexhep Murati, si dhe ndonjë ekspert nga praktika gjyqësore.

Kryetari - Tha se duhet të shikohet nëse këta persona kanë marrë pjesë në grupe punuese në nivel të Qeverisë, nëse nuk kanë qenë, nuk ka ndonjë pengës që t'i angazhojmë. Propozoi ekspertë: Sali Mekaj, Visar Smajlaj dhe Besim Kelmendi.

Ardian Gjini- U pajtua që të formohet grupi punues, kurse për ekspertë propozoi që lista të mos mbyllet, në ndërkohë mund të propozohet edhe ndonjë ekspert tjetër.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion njëzëri nxori këtë:

Përfundim

I. Formohet Grupi i punës për shqyrtimin e Projekt-kodit të procedurës penale në përbërje: Behar Selimi, kryesues, Armend Zemaj, Mufera Sinik, Haki Demolli, Halit Krasniqi dhe Albulena Haxhiu.

II. Ekspertë për ofrimin e mbështetjes profesionale GP dhe Komisionit për Legjislacion për shqyrtimin e Projekt-kodit të procedurës penale caktohen: Regjep Murati dhe Ejup Sahiti - Fakulteti Juridik, Besim Kelmendi – Prokuroria Speciale, Salih Mekaj - Gjykata e Qarkut, Pejë dhe Visar Smajlaj- Ekspert i fushës penale.

4. Shqyrtimi i kërkesës së Këshillit Gjyqësor të Kosovës lidhur me aktivitetet e tij

Kryetari i njoftoi me Kërkesën e Këshillit Gjyqësor të Kosovës lidhur me prezantimin e aktiviteteve të Këshillit Gjyqësor para Kuvendit. Ai e vlerësoi se ka bazë juridike kërkesa e Këshillit Gjyqësor që të paraqitet para Kuvendit dhe të raportojë lidhur me performansën, veprimet, shpenzimet dhe nevojat e gjyqësorit.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion njëzëri nxori këtë:

Përfundim

I. Komisioni e vlerësoi se ka bazë juridike kërkesa e Këshillit Gjyqësor që të paraqitet para Kuvendit dhe të raportojë lidhur me performansën, veprimet, shpenzimet dhe nevojat e gjyqësorit.

II. Kërkohet nga Kryesia e Kuvendit që të veprojë në pajtim me ligjin për Këshillin Gjyqësor të Kosovës.

5. Shqyrtimi i propozimeve për anëtarë të Këshillit në Komisionin për Ndihmë juridike falas

Kryetari i njoftoi me propozimet për anëtarë të Këshillit në Komisionin për Ndihmë juridike falas duke shtuar se disa nga anëtarët e propozuar e kanë dokumentacionin e kompletuar. Propozoi që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për mbledhjen e radhës dhe të kërkohet nga Agjencia për ndihmë juridike të plotësohet dokumentacioni në pajtim me nenin 14 të ligjit për ndihmë juridike falas.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion njëzëri nxori këtë:

Përfundim

Komisioni kërkon nga Agjencia për ndihmë juridike falas që të sillen dëshmi se kandidatët e propozuar i plotësojnë kushtet e parapara me nenin 14 të ligjit për ndihmë juridike.

6. Të ndryshme

a. Shqyrtimi i kërkesës së Presidentes, drejtuar kryetarit të Komisionit, si anëtar në këshillin kombëtar kundër korrupsionit

Kryetari i njoftoi me kërkesën e presidentes e cila ka kërkuar nga kryetari i Komisionit që si anëtar në Këshillin kombëtar kundër korrupsionit të paraqesë raport për punën e Komisionit për Legjislacion.

Ardian Gjini- Theksoi se po shihet që mungon bashkëpunimi ndërinstitutional edhe në këtë aspekt, nuk po flas në mes individëve, nuk ka nevojë t'i drejtohem kryetarit të Komisionit për një raport të tillë. Puna e Komisionit është publike dhe kush do qoftë prej Zyrës së Presidentes mund ta marrë dhe nuk ka nevojë ta kërkojë. Duhet të jemi të kujdesshëm për shkak se nuk është interes i Kosovës, as i Komisionit, as i Kuvendit ta ketë ndonjë fiksion të vogël ndërinstitutional. Ishte i mendimit që një përgjigje duhet t'ia kthej Kryetari i Komisionit dhe i tregon se çka bën Komisioni. Presidentja më tepër e ka pasur fjalën për Task Forc që e ka krijuar vetë, pra, ta provojë ta ngjallë atë Task Forcë dhe kemi të drejtë me thënë se nuk ka prodhuar diçka pozitive në luftë kundër korrupsionit në Kosovë.

Behar Selimi- Mendoj se qëllimi ka qenë shumë i mirë prej fillimit i Presidentes për ta thelluar aktivitetin e institucioneve tona në luftimin e dukurive të këqija. Këtij qëllimi iu kanë përgjigj të gjitha institucionet në mënyrën e tyre, me pjesëmarrje nëpër mbledhje me informacione për situatën, ndoshta shprehja raportim, na ka shtyrë të mendojmë për raportet në mes të institucioneve, në mes të këtyre dy institucioneve. Ishte i mendimit

që t'i përgjigjemi me njoftim për punën e Komisionit i cili ka miratuar një mori ligjesh, e të cilat janë direkt të lidhura me luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Ardian Gjini- Në fjalën e tij të serishme sqaroi se duhet pasur kujdes, sepse Kuvendi nuk i raporton askujt, nuk guxon të ketë kërkesë për raport ndaj Kuvendit. Nuk po them se ky është qëllimi, mirëpo nëse shndërrohet në praktikë atëherë mund të shndërrohet në praktikë shumë problematike për Kosovën, duhet të jetë i qartë se Kuvendi nuk i raporton askujt.

Armend Zemaj- Në fjalën e tij tha se sa i përket formimit të këtyre Këshillave, ju e dini qëndrimin tim, kam thënë gjithmonë që nëse duan të zvarritet një çështje, atëherë bëhet duplikimi i pozitave e caktuara. Ai tha se themelimi i këtij këshilli nga Presidentja vjen nga nevoja për ta luftuar korrupsionin, sepse po shihet qartë se ka arritur deri në atë nivel që edhe Presidentja e vendit ta ketë një fokus të veçantë në këtë drejtim. Mbi këtë arsye unë do të isha shumë parimor, që edhe ju, si kryetar i Komisionit, t'ia përgatitni një informatë të hollësishme rreth punës së Komisionit, por edhe të Kuvendit në aspektin e legjislacionit për luftën kundër korrupsionit.

Kryetari- *I përmbledhi diskutimet duke nxjerrë si konkluzion që t'i dërgojë informatë Presidentes dhe ta informojmë për punën dhe aktivitetet e Komisionit.*

b. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funkcional në Projektligjin Nr. 04/L-116 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L- 04 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë

U shqyrtua raporti me amendamente në Projektligjin Nr. 04/L-116 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L- 04 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe kishte vërejtje në nenin 4 të projektligjit dhe amendamentin 6. neni 4 i Projektligjit dhe amendamenti 6, me të cilin parashihet epërsia e këtij ligji në raport me ligjet dhe aktet e tjera nënligjore, u vlerësua që është në kundërshtim me Kushtetutën dhe ligjet që e mbulojnë këtë fushë, si dhe në kundërshtim me rregullat e hartimit të legjislacionit.

Anëtarët e Komisionit ishin të ndarë në mendime, kundër nenit 4 dhe amendamentit 6, ishin Arben Gashi, Ardian Gjini, Haki Demolli, Armend Zemaj dhe Albulena Haxhiu. Ndërsa për procedim të raportit të Komisionit Funkcional, pa vërejtje ishin: Behar Selimi, Halit Krasniqi dhe Mufera Sinik.

Në momentin e votimit prezent ishin 8 deputetë.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion me pesë vota “për”, dhe tri vota “ kundër” nxori këtë:

Përfundim

1. Projektligji Nr. 04/L-116 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-04, për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, e ka bazën juridike në nenin 65.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, me përjashtim të nenit 4 të Projektligjit.

2. Amendamentet e propozuara e kanë bazën juridike në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, përveç amendamentit 6.

3. Neni 4 i Projektligjit dhe amendamenti 6 i kthehen për rishqyrtim Komisionit Funkcional.

c. Shqyrtimi i kërkesës së Gjykatës Kushtetuese lidhur me ligjin për pensionet e pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës,

Kryetari i njoftoi me kërkesën e Gjykatës Kushtetuese, e cila ka kërkuar nga Komisioni për Legjislacion që ta japë mendimin e vet lidhur me ligjin për pensionet e FSK-së. Propozoi që kërkesa t'i dërgohet Departamentit Ligjor të Kuvendit për procedim të mëtutjeshëm.

Komisioni vendosi që kërkesa t'i dërgohet departamentit ligjor të Kuvendit për procedim të mëtutjeshëm në afatin e përcaktuar.

d. Shqyrtimi i amendamentit në Projekt-kodin penal të Kosovës

Kryetari i njoftoi anëtarët se nga tryeza e organizuar nga Komisioni si konkluzion ka dalë që të hiqen nenet 37 dhe 38 nga Kodi Penal. Meqë edhe neni 39 ka lidhje me dy nenet paraprake është e logjikshme që edhe neni 39 të hiqet.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion njëzëri u pajtua që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

Rekomandim

Të miratohet Amendamenti i propozuar nga Komisioni për Legjislacion

Amendamenti 1

Hiqen nenet 37, 38 dhe 39 i Kodit Penal.

Mbledhja përfundoi në orën 13:10

Kryetari i Komisionit

E përgatiti:

Arben Gashi

Stafi Mbështetës i Komisionit